

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË PRRENJAS

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Prrenjas**, me objekt: *“Mbi vlerësimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, aktivitetin ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve të qëndrueshme, dhënien me qira të objekteve, funksionimi i policisë, prokurimet me fonde publike, taksat dhe tarifat vendore, etj.”*, lloji i auditimit: *“Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare”*, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 30.06.2014 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 139, datë 30.06.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 613/9, datë 30.09.2014, i ka rekomanduar z. Bajazit Karriqi, Kryetar i Bashkisë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje: Gjatë auditimit është konstatuar se megjithë punën e bërë nuk janë zbatuar të gjitha detyrat e lëna nga auditimi i mëparshëm ushtruar nga KLSH, veprime në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit" ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1.6.2000.

1.1 Rekomandim:

Bashkia Prrenjas, Zyra e Financës në bashkëpunim me zyrat e tjera të Bashkisë të marrë të gjitha masat për arkëtimin e detyrimeve të prapambetura lënë nga auditimi i mëparshëm i KLSH në vlerën 5,658,429 lekë, rikërkuar për zbatim me shkresën nr.1336/24, datë 29.03.2013.

Menjëherë

2. Gjetje: Gjatë auditimit është konstatuar se nuk janë zbatuar drejtë kërkesat e ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 *“Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”*, pasi Nëpunës Autorizues është caktuar punonjësja e auditit të brendshëm dhe nuk është caktuar fare Nëpunësi zbatues.

2.1 Rekomandim:

Titullari i Bashkisë Prrenjas, Librazhd të marrë të gjitha masat për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit si dhe të metodologjisë për zbatimin e tij.

Menjëherë

3. Gjetje: Gjatë auditimit është konstatuar se në miratimin e strukturës dhe organikës së administratës të Bashkisë, me VKB nr.10, datë 27.02.2014 *“Për miratimin e strukturës organizative të administratës dhe nivelin e pagave”*, nuk është pasur parasysh aktiviteti ekonomiko-financiar i njësisë vendore dhe mundësitë financiare në realizimin e të ardhurave vendore, bazuar në kërkesat e VKM nr.518, datë 16.08.2012 *“Për disa ndryshime në VKM nr.1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të qeverisjes vendore”*.

3.1 Rekomandim:

Titullari i Bashkisë Prrenjas, Librazhd, në bashkëpunim me Këshillin e Bashkisë të marrë të gjitha masat për rishikimin dhe riorganizimin e strukturës dhe organikës së administratës së Bashkisë, me qëllim rritjen e efektivitetit të punës së administratës, zvogëlimin e numrit të punonjësve të tepërt në administratë dhe shkurtimin e shpenzimeve të pagave.

Menjëherë

4. Gjetje: Gjatë auditimit është konstatuar se planifikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore nuk është shumë i studiuar me argumente bindëse dhe drejtime sipas mundësive reale të njësisë vendore, duke krijuar oshilacione dhe mosrealizime të ndieshme, nuk është ndjekur si dhe sa duhet arkëtimi i detyrimeve të pa paguara në afat për taksat vendore dhe detyrimet e trashëguara, sipas kërkesave të Udhëzimit të përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë Financave nr. 655/1, datë 06.02.2007 “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksave vendore”, pika 10, “Kontrolli tatimor”.

4.1 Rekomandim:

Bashkia dhe Zyra e Taksave e Tarifave Vendore, të marrë masa për hartimin e planit vjetor të kontrolleve në drejtimet e përcaktuara.

Menjëherë

4.2 Rekomandim:

Bashkia dhe Zyra e Taksave e Tarifave Vendore të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha hapat ligjore për ndjekjen dhe arkëtimin e detyrimeve tatimore që arkëtohen nga njësitë e tjera publike (DPSHTRR, ZVRPP) etj, duke bërë rakordime periodike më të plotë të taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme dhe taksën e regjistrimit të përvitshëm të mjeteve të transportit. Kjo duke ushtruar të drejtën ligjore për të ndikuar mbi agjentët tatimor, të cilët duhet të sjellin ndryshime në rritje të treguesve të planifikimit, realizimit në fakt të ardhurave si dhe dokumentacionit të mbajtur për këtë qëllim.

Vazhdimisht

4.3 Rekomandim:

Zyra e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me Zyrën e financës dhe Zyrat e tjera të Bashkisë, të marrë masa për kontabilizimin dhe arkëtimin e detyrimeve të pa likuiduara deri më datën 30.06.2014 gjithsej në vlerën **3,276,600 lekë** e cila përbëhet nga detyrime të trashëguara deri në vitin 2011 në vlerën 1,736,000 lekë dhe detyrime të vitit 2013 në vlerën 1,540,000 lekë, sipas evidencës bashkëlidhur.

Vazhdimisht

5. Gjetje: Gjatë auditimit është konstatuar se megjithë punën e bërë për dokumentimin dhe inventarizimin e aseteve dhe pronave publike të Bashkisë akoma nuk është realizuar vlerësimi i tyre dhe regjistrimi në kontabilitet dhe ZVRPP Librazhd, në zbatim të kërkesave të VKM nr. 500, datë 14.08.2001 “Për inventarizimin e pronave të paluajtshme shtetërore” dhe VKM. nr. 698, datë 19.10.2007, VKM. nr. 691, datë 21.05.2008, VKM. nr. 1642, datë 17.12.2008, VKM. nr. 525, datë 30.06.2010 dhe VKM. nr. 834, datë 30.11.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose përdorim të Bashkisë Prrenjas, të Qarkut Elbasan”, me qëllim sigurimin e të ardhurave për Bashkinë.

5.1 Rekomandim:

Bashkia Prrenjas, të marrë të gjitha masat për vlerësimin e aseteve, regjistrimin e tyre në ZVRPP Librazhd, marrjen në dorëzim të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, dhënien e tyre me qira dhe regjistrimin e aseteve në bilancin kontabël sipas ligjit për kontabilitetin.

Menjëherë

6. Gjetje: Gjatë auditimit është konstatuar se për dy leje ndërtimi të miratuara nga ish KRRT e Bashkisë në vitin 2010 nga subjektet që kanë kërkuar ato nuk është paguar taksa e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 2,903,388 lekë, bazuar në kërkesat e ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” ndryshuar me ligjin nr.10119, datë 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, detyrë kjo e lënë edhe në auditimin e mëparshëm nga KLSH.

6.1 Rekomandim:

Zyra e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit (Urbanistikës) të paraqesë në Këshillin Teknik të Bashkisë kërkesën e argumentuar ligjërisht për anulimin e dy lejeve të ndërtimit të dhëna para tre viteve për tejkalim afati dhe mos pagim detyrimi për taksën e ndikimit në infrastrukturë në vlerën 2,903,388 lekë.

Menjëherë

7. **Gjetje:** Gjatë auditimit është konstatuar se Autoriteti Kontraktor me prokurimin publik për objektin “Ndërtim Unaza Prrenjas Fshat- Katjel” ka shpallur fitues operatorin ekonomik “V...H...” dhe lidhur kontratën për punë publike nr.372, datë 27.09.2012 në vlerën 65,708,400 lekë me afat përfundimi 270 ditë i cili me datë 25.06.2013 është shtyrë dorëzimi i objektit edhe për tre muaj tjerë ose deri më 26.09.2013.

Nga auditimi i dokumentacionit rezulton se:

Sipërmarrësi “V...H...” akoma nuk ka dorëzuar për likuidim situacionin përfundimtar të punimeve.

Megjithëse kanë kaluar 300 ditë kalendarike nga afati i dorëzimit të objektit akoma nuk është marrë në dorëzim nga Bashkia.

Mbikqyrësi i punimeve E.Ç. nuk ka dorëzuar të kompletuar dosjen teknike të zbatimit të punimeve.

Në këtë dosje janë administruar njoftimi i operatorit ekonomik për përfundimin e punimeve nr.extra datë 26.09.2013 drejtuar mbikëqyrësit të punimeve E.Ç. e cila me shkresën nr.76/1 datë 26.09.2013 drejtuar Bashkisë Prrenjas ka njoftuar përfundimin e zbatimit të punimeve por nga auditimi rezulton se këto dokumente nuk janë të protokolluara dhe administruara në Bashkinë Prrenjas.

Sipas situacioneve të paraqitura nga sipërmarrësi deri më datë 26.07.2014 Bashkia Prrenjas ka likuiduar vlerën 42,343,014 lekë dhe ka mbetur pa likuiduar vlera 23,365,386 lekë mbi të cilën nga llogaritja e penaliteteve për dorëzim me vonesa të punimeve rezulton vlera **14,019,231 lekë**.

Nga kontrolli fizik në objekt, u konstatua se objekti është në shfrytëzim pra punimet kanë përfunduar dhe sipas shpjegimeve të punonjësve dhe të Autoritetit Kontraktor rezulton se: “Punimet në objekt kanë përfunduar brenda afatit 26.09.2013 dhe objekti është në shfrytëzim që nga ajo ditë por dokumentacioni për përfundimin e punimeve dhe dorëzimin e objektit nuk është hartuar nga sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve për arsye të mungesës së burimeve financiare të Bashkisë për likuidimin e punimeve të kontraktuara të kryera nga sipërmarrësi në vlerën 23,365,386 lekë”.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar me ligjin nr. 20/13, datë 14.02.2013 dhe me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 “Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar.

7.1 Rekomandim:

Mbështetur në nenin 62 dhe 63 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nisur nga kërkesa e operatorit ekonomik “V...H...” për përfundimin e punimeve nr.extra, datë 26.09.2013 drejtuar mbikëqyrësit të punimeve E...Ç... e cila me shkresën nr.76/1, datë 26.09.2013 drejtuar Bashkisë Prrenjas, për përfundimin e punimeve, KLSH rekomandon që Autoriteti Kontraktor, Bashkia Prrenjas, të marrë masat përkatëse duke ngritur një grup pune me specialistë të fushës për vlerësimin e situatës lidhur me përfundimin e punimeve dhe pas plotësimit të gjithë dokumentacionit tekniko-ligjor, marrjes në dorëzim të objektit dhe nxjerrjes së konkluzionit përfundimtar lidhur me argumentimin e vonesës në dorëzimin e objektit, midis operatorit ekonomik sipërmarrës, mbikëqyrësit të punimeve dhe vetë Bashkisë Prrenjas të nxjerrë përgjegjësinë për zbatimin ose moszbatimin e sanksioneve për ditë vonesa sipas DST në dorëzimin e objektit në vlerën 14,019,231 lekë.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Mbështetur në ligjin nr.8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurës administrative” pjesa V, Kreu IV, nent 105- 109 dhe UMF nr.30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, Kapitulli IV “Sistemet e kontrollit periodik të aktiveve” pika 93, nga ana e titullarit të njësisë publike (Nëpunësi Autorizues), të nxirren aktet administrative, me qëllim kërkimin për shpërblimin e dëmit në vlerën **19,886,726 lekë** si më poshtë:

1. Gjetje: Gjatë auditimit janë konstatuar pagesa të tepërta në vlerën **3,305,328 lekë** si rezlutat i situacionimit të punimeve të pa kryera të shërbimit të pastrimit të qytetit Prrenjas nga operatori ekonomik “D...”, në kundërshtim me pikën 1, neni 15 të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe të VKM nr.175, datë 19.01.2011 “Për pastrimin dhe largimin e mbeturinave publike”.

1.1 Rekomandim:

Vlera 3,305,328 lekë në ngarkim të operatorit ekonomik “D...” nga e cila vlera 103,224 lekë për situacionimin e punimeve të pa kryera në periudhën nga 07.03.2012 deri më 06.07.2012 dhe vlera 3,202,104 lekë për preventivimin, shpalljen fitues në tenderat me datë 07.03.2012 dhe datë 28.06.2012, lidhjen e kontratës së shërbimit të pastrimit nr.112/3, datë 07.03.2012 për periudhën 4 mujore dhe kontratës nr.406, datë 30.07.2012 për periudhën 5 vjeçare dhe situacionet mujore të punimeve të pa kryera në shërbimin e pastrimit të qytetit Prrenjas.

Brenda afatit të kontratës

2. Gjetje: Gjatë auditimit është konstatuar dëm ekonomik gjithsej në vlerën **14,711,671 lekë** nga operatori ekonomik “V...H...” nga e cila pagesa të tepërta në vlerën 692,440 lekë për situacionimin e punimeve të pa kryera në 4 zëra punimesh, në kundërshtim me pikën 1, neni 15 të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” dhe tejkalim afati të zbatimit të kontratës për punë publike në vlerën 14,019,231 lekë në objektin “Ndërtim Unaza Prrenjas Fshat-Katjel”, sipas kontratës datë 27.09.2012, në kundërshtim me nenin 20 “Dokumentet Standarde të tenderit” pika 20.1 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar.

2.1 Rekomandim:

Vlera 14,711,671 lekë në ngarkim të operatorit ekonomik “V...H...” nga e cila për situacionimin e punimeve të pa kryera në 4 zëra punimesh për vlerën 692,440 lekë dhe tejkalim afati të zbatimit të kontratës për punë publike në vlerën 14,019,231 lekë në objektin “Ndërtim Unaza Prrenjas Fshat-Katjel”, sipas kontratës datë 27.09.2012.

Në likuidimin e situacionit përfundimtar

3. Gjetje: Gjatë auditimit është konstatuar dëm ekonomik gjithsej në vlerën **215,992 lekë** nga subjekti fizik **A.R.** për përfitim pa drejtësisht TVSH, likuiduar me u.shpenzimet nr.100, nr.101, nr.102, datë 05.04.2013 dhe nr.145, datë 09.04.2014, për blerje dru zjarri, në kundërshtim me kontratën nr.552/1, datë 12.11.2012 dhe me kërkesat e nenit 12 pika 3 germa “e” të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

3.1 Rekomandim:

Vlera 215,992 lekë në ngarkim të subjektit fizik A.R. për përfitim pa drejtësisht TVSH, likuiduar me u.shpenzimet nr.100, nr.101, nr.102, datë 05.04.2013 dhe nr.145, datë 09.04.2014, për blerje dru zjarri, në kundërshtim me kontratën nr.552/1, datë 12.11.2012.

Brenda datës 31.10.2014

4. Gjetje: Gjatë auditimit është konstatuar dëm ekonomik gjithsej në vlerën **1,576,135 lekë** për situacionimin e punimeve të pa kryera në 5 zëra punimesh, në kundërshtim me pikën 1, neni 15 të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

4.1 Rekomandim:

Vlera 1,576,135 lekë në ngarkim të operatorit ekonomik “H...” për situacionimin e punimeve të pa kryera në 5 zëra punimesh në objektin “Ndërtim Ujësjiellësi fshati Rashtan” sipas kontratës 245/3, datë 02.07.2013, në kundërshtim me pikën 1, neni 15 të ligjit nr.8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”.

Në likuidimin e situacionit përfundimtar

5. Gjetje: Gjatë auditimit është konstatuar dëm ekonomik gjithsej në vlerën **77,600 lekë** për përfitim pagesa të tepërta nga tre punonjës të administratës për interpretim të gabuar i nivelit të pagës si diferenca midis shkollës së lartë dhe shkollës së mesme, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr.518, datë 16.08.2012 “Për disa ndryshime në VKM nr.1619, datë 02.07.2008 “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të qeverisjes vendore”

5.1 Rekomandim:

Vlera 77,600 lekë në ngarkim të tre punonjësve të administratës së Bashkisë për përfitim pagese më tepër nga diferenca e nivelit të pagës dhe diplomës midis shkollës së lartë dhe shkollës së mesme, dhe konkretisht:

- O.M. me detyrë magazinierë në vlerën 1,000 lekë
- P.B. me detyrë inspektore e ndihmës ekonomike në vlerën 25,000 lekë
- D.C. me detyrë inspektor arsim, kulturë, sport në vlerën 51,600 lekë.

Brenda datës 31.10.2014

C. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, në nenin 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar dhe në nenin 12 të kontratës individuale të punës i rekomandojmë Kryetarit të Bashkisë Prrenjas, Librazhd, që të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore, **për 11 (njëmbëdhjetë) punonjësit** si më poshtë:

C.1. “Vërejtje me shkrim”, sipas nenit 12,a (Sanksione të kontratës individuale të punës)

1. zj. A.B. me detyrë inspektore e zyrës së Auditit të Brendshëm, në cilësinë e Nëpunësit Autorizues.

-Për shkeljet e konstatuara në përmbushjen e nenit 8, pika 8 germa “e”, nenit 12, 17,19,20,21,22 dhe 27 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” për vitin 2012-2013 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2014, pasi ka pranuar caktimin si Nënus Autorizues, nuk është caktuar Nëpunësi Zbatues, nuk është krijuar Grupi i Menaxhimit Strategjik (GSM), nuk janë përcaktuar procedurat e brendshme të antikorrupsionit dhe sinjalizimit të parregullsive, nuk ë hartuar dhe miratuar plani i veprimit afatmesëm për rishikimin e sistemeve të brendshme të kontrollit, nuk pasqyrohet procesi i vlerësimit të kontrollit të brendshëm, nuk përcaktuar si duhet objektivat, misioni dhe vizioni i Bashkisë.

2. z. B.K. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Financës.

-Për shkeljet e konstatuara në përcaktimin e pagave të tre punonjësve të administratës në 6 mujorin e parë të vitit 2014 ku si rezultat i interpretimit të gabuar të tabelës së pagave kanë përfituar më tepër pagë në vlerën 77,600 lekë, veprime në kundërshtim me VKM nr. 518, datë 16.08.2012 “Për disa ndryshime në VKM nr.1619, datë 02.07.2008 ‘ “Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e njësive të qeverisjes vendore për efekt page dhe caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të qeverisjes vendore”.

3. z. E.Sh. me detyrë Inspektor i Policisë së Bashkisë.

-Për shkeljet e konstatuara në organizimin dhe funksionimin e Policisë Bashkiake pasi nuk është propozuar për miratim në Këshillin e Bashkisë paketa me llojet e gjobës për çdo shkelje që përbën kundërvajtje administrative, edhe pse janë konstatuar shkelje dhe janë mbajtur procesverbale në asnjë rast nuk janë aplikuar gjoba, veprime në kundërshtim me nenin 8 pikat 6,9 dhe 15 të ligjit nr.8335, datë 23.04.1998 *“Për organizimin dhe funksionimin e Policisë të Bashkisë dhe të Komunës”*.

C.2 “Vërejtje me paralajmërim për largim nga puna”, sipas nenit 12,b (Sanksione të kontratës individuale të punës)

4. zj. B.K. me detyrë ish Përgjegjëse e Zyrës së Financës në cilësinë e kryetarit të komisionit të prokurimit me vlera të vogla dhe anëtarit në njësinë e prokurimit, për periudhën nga 01.01.2012 deri më 30.09.2013.

5. zj. M.K. me detyrë Përgjegjëse e zyrës së taksave vendore, në cilësinë e kryetarit të komisionit të blerjeve në vlera të vogla dhe anëtar i KVO.

6 z. F.B. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Arsimit, Kulturës dhe Sporteve, në cilësinë anëtarit të komisionit të prokurimit me vlera të vogla.

-Për shkeljet e konstatuara në procedurat e blerjeve në vlera të vogla për vitin 2012-2013 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2014, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar në kreun VI pika 2 *“Prokurimi me vlerë të vogël”* të VKM nr. 1, datë 10.1.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”* i ndryshuar dhe të Udhëzimit të KM nr.2, datë 18.2.2008 *“Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”* i ndryshuar.

7. zj. J.A. me detyrë Juriste në njësinë e prokurimit.

8. z. H.K. me detyrë Përgjegjës i Zyrës së Urbanistikës, në cilësinë anëtarit të njësisë së prokurimit.

9. z. P.T. me detyrë Përgjegjës i zyrës së Shërbimeve, në cilësinë e Kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave dhe preventivues.

10. z. A.K. me detyrë inspektor i ndërtimit urbanistik, në cilësinë anëtarit të KVO

11. z. M.K. me detyrë specialist në cilësinë anëtarit të komisionit të prokurimit me vlera të vogla dhe mbikëqyrës i shërbimit të pastrimit të qytetit.

-Për shkeljet e konstatuara në procedurat e prokurimeve publike, në hartimin e dokumenteve të tenderit, në hartimin e preventivave, në përzgjedhjen e procedurës së prokurimit, në shpalljen e fituesit dhe në zbatimin e kontratave për vitin 2012 dhe 2013 dhe 6 mujorin e parë të vitit 2014, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”* i ndryshuar në VKM nr. 1, datë 10.1.2007 *“Për rregullat e prokurimit publik”* i ndryshuar.

D. MASA ADMINISTRATIVE

Mbështetur në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr.8270, datë 23.12.1997 *“Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”*, ndryshuar me ligjin nr.8599, datë 01.06.2000, në pikën 1, të nenit 15, të ligjit 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar me ligjin nr. 20/13, datë 14.02.2013, që për shkelje të ligjshmërisë në mbikëqyrjen e zbatimit të punimeve të ndërtimit, ti propozojë INUV-it, Bashkia Prrenjas, të vendosë sanksionet si më poshtë:

- Dënimin me gjobë të mbikëqyrësve të punimeve të ndërtimit, respektivisht:

1.znj. E.Ç. e licencuar (licenca me nr. MK 1476/4), me të cilën është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 372/1, datë 27.09.2012, për shkak se:

a- Ka lejuar vonesa të pajustificuara me 10 muaj, kundrejt afatit të parashikuar për kryerjen e punimeve në objektin **“Ndërtim i Unazës Prrenjas Fshat-Katjel”**, me pasojë shkaktimin e

dëmit ekonomik buxhetit të shtetit në vlerën **14,019,231 lekë**, në kundërshtim me kontratën lidhur midis palëve datë 28.06.2011 i cili përcakton afatin e përfundimit të objektit 270 ditë nga dita e lidhjes kontratës dhe miratim shtyrje afati deri në 365 ditë, ndërkohë që afati i punimeve ka kaluar 10 muaj dhe deri me datën 29.07.2014, objekti ende nuk është marrë në dorëzim nga Bashkia.

b- Mungojnë provat laboratorike për materialet e shtresave dhe raportet e testimit për materialin e shtresës së stabilizantit, gjithashtu provat laboratorike për betonet M-150 dhe shtresat asfaltike, nuk janë të mjaftueshme, pasi është bërë vetëm një provë, duke mos përmbushur kërkesat e standardeve shqiptare.

c- Punimet e ndërtimit nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit e të zbatimit dhe librezat e masave për përshkrimin e punimeve sipas grafikut dhe projekt zbatimit, nuk pasqyron me vërtetësi punimet e kryera për të përcaktuar saktë volumet e punimeve.

d- Si rezultat i situacionimit të katër zëra punimesh të pa kryera në vlerën **692,440 lekë** ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik **“V...H...”**.

2.znj. Xh.D. e licencuar (licenca me MK 08779/3), me të cilën është lidhur kontrata e shërbimit me nr. 245/5, datë 02.07.2013, për shkak se:

a- Punimet e ndërtimit në objektin **“Ndërtim Ujësjiellësi fshati Rashtan”** nuk janë zbatuar në përputhje me kushtet teknike të projektimit e të zbatimit dhe librezat e masave për përshkrimin e punimeve sipas grafikut dhe projekt zbatimit, nuk pasqyron me vërtetësi punimet e kryera për të përcaktuar saktë volumet e punimeve.

b - Si rezultat i situacionimit të pesë zëra punimesh të pa kryera në vlerën **1,576,135 lekë** ka krijuar mundësinë e përfitimit të pa drejtë nga operatori ekonomik **“H...”**.

Veprimet e mësipërme bien në kundërshtim me nenin 7, të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar dhe me Udhëzimin nr. 3, datë 15.02.2001 *“Për Mbikëqyrjen dhe Kolaudimin e Punimeve të Ndërtimit”*, i ndryshuar.

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Halil Isufi, Abdulla Duka, Luan Kuka dhe Lolita Baholli më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike, dhe Zbatimit të Standardeve, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Luljeta Nano, Sekretar i Përgjithshëm.

KONTROLI I LARTË I SHTETIT